



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 1583/Prot.
14

Tiranë, më 6/12/2013

Lënda: Rekomandim për kontrolluesin *Sheraton Tirana Hotel*.

REKOMANDIM

Nr. 53 datë 06/12 2013

Mbështetur në Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr.211, datë 11.09.2008 “Për zgjedhjen e komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe nr 225, datë 13.11.2008 “Për miratimin e strukturës organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetim Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit, *Sheraton Tirana Hotel*.

KONSTATOVA

Në datë 08/11/2013 Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka zhvilluar kontroll administrativ pranë kontrolluesit, *Sheraton Tirana Hotel* me objekt:

- Ligjshmëria e përpunimit të të dhënave personale për subjektet e të dhënave personale, “klient”, “punonjës” sipas ligjit 9887 datë 10/10/2013 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” udhëzimit nr. 10 datë 06/09/2011 “Përpunimi i të dhënave personale në kuadër të shërbimeve hotelerie”
- Procesi i njoftim regjistrimit (neni 21).

Kontrolluesi ushtron aktivitet privat në fushën e hoteleri turizëm në qytetin e Tiranës, në këndvështrimin e ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, kontrolluesi *Sheraton Tirana Hotel* merr cilësinë e kontrolluesit, pasi gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij mbledh dhe përpunon të dhëna personale për kategorinë e subjekteve të të dhënave “klientë” dhe “punonjës”.

Ligji nr. 9887 datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, në nenin 3 përkufizon; “Kontrollues” është çdo person fizik ose juridik, autoritet publik, agjenci apo ndonjë organ tjetër që, vetëm apo së bashku me të tjerë, përcakton qëllimet dhe mënyrat e përpunimit të të dhënave personale, në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore të fushës, dhe përgjigjet për përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj.

Nisur nga relacioni i grupit të kontrollit administrativ dhe procesverbali i kontrollit të mbajtur nga grupi i kontrollit rezulton se; kontrolluesi *Sheraton Tirana Hotel* mbledh dhe përpunon të dhëna personale në rrugë manuale dhe në rrugë elektronike nëpërmjet sistemeve elektronike.

Përpunimi i të dhënave në rrugë manuale për kategoritë e subjekteve të të dhënave personale “klient dhe “punonjës” bëhet nëpërmjet plotësimit të formularit të regjistrimit/kartës së klientit (për klientët) dhe nëpërmjet plotësimit të dokumentacionit të kërkuar (çek listë) në rastin e kategorisë “punonjës”.

Përpunimi i të dhënave personale në rrugë elektronike realizohet nëpërmjet sistemeve elektronike që kontrolluesi ka për kryerjen e rezervimeve online për kategorinë “klient” dhe sistemit elektronik të menaxhimit të burimeve njerëzore për kategorinë e subjekteve të të dhënave “punonjës”.

Nga kontrolli administrativ i ushtruar rezulton se kontrolluesi *Sheraton Tirana Hotel*, garanton mbrojtje të të dhënave personale, nëpërmjet përpunimit të drejtë, të ligjshëm dhe të sigurt të tyre, në sajë të masave që kontrolluesi ka marrë.

Kontrolluesi zbaton politika për sigurinë e informacionit të përmbledhura në dokumentin “*Global information security policies fundamentals*” të grupit “Starwood”. Të gjitha proceset e biznesit, kompjuterët dhe sistemet informatike të rrjetave të kontrolluesit janë objekt i këtyre politikave. Brenda këtij dokumenti përfshihet:

- Mbrojtja e identitetit dhe menaxhimi i eksedit
- Mbrojtja e veçantë e kartave të kreditit
- Siguria fizike e ambienteve
- Mbrojtja dhe zhvillimi i programeve kompjuterik
- Menaxhimi i riskut dhe përgjigja ndaj incidenteve
- Kontrolluesi ka hartuar “Manualin e Punonjësve”, “politika dhe procedura të përgjithshme”.

Pavarësisht sa më sipër, grupi i kontrollit administrativ në procesverbalin e mbajtur në datën 13/11/2013 ka konstatuar se;

- Kontrolluesi *Sheraton Tirana Hotel* gjatë mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave personale të klientëve në “*format e regjistrimit*”/karta e klientit, nuk ka bërë informimin e plotë subjekteve të të dhënave personale, lidhur me fushën dhe qëllimit për të cilat mbledhen dhe përpunohen të dhënat personale, personin që do të përpunojë këto të dhëna, mënyrat e përpunimit, të drejtat e subjekteve të të dhënave etj si kundër parashikohen në nenin 18 të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*”.
- Kontrolluesi *Sheraton Tirana Hotel*, në njoftimin e bërë pranë Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, nuk ka deklaruar saktë qëllimin e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave personale për kategorinë e subjekteve të të dhënave klient dhe kategoritë e subjekteve të të dhënave personale për të cilat kontrolluesi mbledh dhe përpunon të dhëna personale.

Duke vlerësuar konstatimet e grupit të kontrollit administrativ në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*”, si dhe 107-109 të K.Pr.Administrative ;

REKOMANDOJ

1. Në zbatim të nenit 18 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*” i ndryshuar, kontrolluesi *Sheraton Tirana Hotel* në “*formularin e regjistrimit*”/kartën e klientit, të bëjë informimin e subjekteve të të dhënave personale për fushën dhe qëllimin për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, për

personin e ngarkuar (personin e kontaktit) për mbrojtjen e të dhënave personale, për mënyrën e përpunimit, të informojë subjektet e të dhënave për të drejtën për akses, si dhe të drejtën për korrigjim të të dhënave personale.

2. Kryerja e detyrave të lëna në këtë Rekomandim, të realizohet brenda një afati kohor prej 1 (një) muaj, duke filluar ky afat nga dita e marrjes dijeni të këtij rekomandimi.
3. Me plotësimin e këtyre detyrimeve të njoftohet me shkrim pranë Komisionierit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
4. Në rast mospërbushje të këtij Rekomandimi, Komisioneri vepron sipas neni 30, pika 2, të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “ Për mbrojtjen e të dhënave personale, sipas të cilit *“Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave”*.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

KOMISIONERI

FLORA CABEJ (POGAÇE

